

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (Shpk) "Enti privat: Shtypshkronja "Gjergj Fishta" Lezhë"

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Enti privat Shtypshkronja" Gjergj Fishta" Lezhë krijohet nga Ortaku i Vetëm Frano Kulli, banues në qytetin e Lezhës.

Shoqëria ka për qëllim të zhvillojë aktivitetin e saj ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në dispozitat e parashikuara në këtë statut.

I-VENDQËNDRIMI:

NENI 1

Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Enti privat: Shtypshkronja "Gjegj Fishta" (Shpk) është në qytetin e Lezhës. Shoqëria mund të hapë edhe vendqëndrime të dyta, agjensi e përfaqësi në tëgjthë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë vendit me miratimin e organeve përkatëse sipas ligjit.

II- EMËRTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, JETËGJATËSIA

NENI 2

Në bazë të ligjës 7512 datë 10. 8. 1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privarizimit" dhe ligjës 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" me vullnetin e lirë të Ortakut të Vetëm Z. Frano Kulli krijohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Enti privat: Shtypshkronja "Gjergj Fishta" Lezhë (Shpk).

Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar. Ajo është person juridik shqiptar që zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe të akteve të saj themelore.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Shtypshkrime të gazetave, revistave, librave të këtij lloji që botohen brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë tij.
- Shtypshkrimeve të porositësve shtetërorë e privatë, nga të gjithë sektorët.
- Import-export të paisjeve e lëndëve të para që lidhen me aktivitetin e shtypshkronjës.
- Tregtim (import-export), të paisjeve elektronike, paisje grafike dhe artikuj shkollorë.
- Tregtim i librit shkencor, kasete e videokaseta.

NENI 4

Jetëgjatësia e shoqërisë është mbi 12 vjet.

Me vendim të Ortakut të Vetëm apo kur verifikohen rrethana të tilla kur ligja urdhëron shprehimisht shpërndarjen e saj, shoqëria mund të shpërndahet përpara këtij afati.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË



NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 lekë.
Ai i përket tërësisht Ortakut të Vetëm dhe është nënshkruar e shlyer prej tij tërësisht.
Me vendim të Ortakut të Vetëm, i cili regjistrohet në Librin e Shoqërisë, kapitali mund të ndryshohet.

Është e ndaluar që kapitali të përfaqësohet në letra me vlerë të tregëtueshme apo shërbime.

NENI 6

Kapitali themeltar është i ndaarë në kuota nga 1000 lekë secila apo shumëfisha të saj.
Për transferimin e të gjitha llojeve të kapitalit dhe tek çdo subjekt është kompetent Ortaku i Vetëm.

NENI 7

Shoqëria ka të drejtë të vërë peng një pjesë të kapitalit ta saj themeltar. Në rast shitjeje të detyruar të pjesëve të lira të lëna peng, pengmarrësi do të pranohet si person, të cilit i janë transferuar pjesë të kapitalit themeltar.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË, ADMINISTRIMI

NENI 8

Ortaku i Vetëm është organi më i lartë i shoqërisë. Atij i takojnë të gjitha kompetencat që në ligjin "Për Shoqëritë Tregëtare" i janë dhënë Asamblesë së Ortakëve.

Vendimet e Ortakut të Vetëm regjistrohen në Librin e Shoqërisë.

NENI 9

Çdo i interesuar mund të kërkojë në Gjykatën e rrethit Tiranë anulimin e vendimeve të Ortakut të vetëm të marrë në kundërshtim me ligjin dhe normat e këtij statuti.

NENI 10

Shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm, i cili është njëherësh edhe Ortak i Vetëm i Shoqërisë, **Z.Frano Kulli** me adresë: Lagja "Skënderbeg" Lezhë.

NENI 11

Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim administrimi në interes të shoqërisë, brenda objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 12

Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur këto nuk përfshihen në objektin e veprimtarisë së saj, me përjashtim të rasteve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit tejkalonte objektin e veprimtarisë së shoqërisë, ose nuk mund ta injoronin këtë fakt në rrethana të caktuara.

NENI 13

Administratorit i takon firma e shoqërisë dhe përfaqësimi i saj ndaj të tretëve.



K R E U I V

Bilanci dhe fitimet.

NENI 14

Viti financiar i shoqërisë mbyllet me datën 31.dhjetor të çdo viti.
Në këtë rast administratori bën inventarin dhe llogaritë vjetore sipas dispozitave të ligjit "Për Kontabilitetin" dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Bilancit i bashkohen:

- Një situacion për garancitë e dhëna nga shoqëria.
- Një situacion për sigurimet e blera nga shoqëria.

NENI 15

Përderisa "Rezerva e domosdoshme" të arrijë 1/10 e kapitalit themeltar, shoqëria është e detyruar të depozitojë në fund të çdo viti 1/20 pjesë të fitimit të realizuar.

NENI 16

Fitimet, pasi të jenë depozituar shumat e urdhëruara për rezervën etj, i takojnë tërësisht Ortakut të Vetëm.

NENI 17

Bilanci vjetor duhet të paraqitet brenda datës 31.mars, të vitit pasardhës.

K R E U V

Mardhënjet e punës

NENI 18

Mardhënjet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çeshtjet që nuk rregullohen me kontratën e punës zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.

NENI 19

Shoqëria merr përsipër të respektojë të gjitha rregullat në fuqi të punësimit dhe për sigurimet shoqërore për të gjithë të punësuarit në shoqëri, ndërsa këta të fundit janë të detyruar të respektojnë statutin e saj. Të punësuarit në shoqëri përgjigjen në bazë të këtij statuti për zbatimin e detyrave të ngarkuara dhe për dëmet e shkaktuara shoqërisë mbajnë përgjegjësi ligjore.

NENI 20

Punonjësit e emruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria, nëse kontratat e punës nuk e përmbajnë një gjë të tillë. Ata nuk marrin cilësinë e Ortakut në shoqëri dhe as që mund të zhvillojnë një aktivitet konkurrues të çfarëdo lloji për llogari të tyre apo të të tretëve, përveç rasteve të autorizuara nga Ortaku i vetëm. Për çdo shkelje në këtë drejtim punonjësi largohet nga puna dhe përgjigjet për dëmet e shkaktuara.

NENI 21

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Sekret pune paraqesin materialet dhe aktet të cilat me ligj e dispozita të veçanta si dhe me vendimet e Ortakut të Vetëm janë shpallur si të tilla.

K R E U VI

Kontrolli i brendëshëm

NENI 22

Shoqëria organizon kontrollin e brendëshëm me ekspertë kontabël të autorizuar, të emruar ose me afat të caktuar.

Eksperti kontrollon dhe garanton që llogaritë vjetore janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet, që japin pasqyrim besnik të rezultateve të operacioneve të vitit të kaluar financiar, të gjendjes financiare dhe të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar. Ata kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të shoqërisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Veprimet e shoqërisë mbylLEN me 31 dhjetor të çdo viti me urdhër të Ortakut të Vetëm. Të ardhurat neto dhe humbjet pas zbritjes së detyrimeve fiskale dhe të krijimit të fondit të akumulimit, i mbeten Ortakut të vetëm si pasuri e tij, i cili, pastaj vendos vetë për krijimin dhe përdorimin e çdo fondi të shoqërisë.

K R E U V I I

Shpërbërja e shoqërisë

NENI 23

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë, si në rast falimentimi, privim i të drejtave për të ushtruar një profesion industrial, tregtar etj. Në rast se Ortaku i Vetëm vendos mbi mënyrën e likuidimit duke caktuar një ose më shumë likuidatorë. Likuidatori merr të gjitha atributet e Ortakut të vetëm dhe ky i fundit merr të drejtën të njihet me zhvillimin e punëve të Shoqërisë, e cila për gjithë kohën që është në likuidim emërtohet "Shoqëri në likuidim".

NENI 24

Me mbarimin e formaliteteve të likuidimit shoqëria pushon aktivitetin e saj dhe ç'rregjistrohet nga Rregjistri Tregtar.

K R E U V I I I

Dispozita të Përgjithshme

NENI 25

Shoqëria vepron si person juridik që nga dita e regjistrimit në gjykatën e rrethit të Tiranës, ndërsa ushtron aktivitet ekonomik privat në bazë të statutit dhe të lejes së ushtrimit të profesionit të marrë nga organi kompetent.

NENI 26

Përsa nuk parashikohet në këtë statut i referohet legjislacionit në fuqi.

NENI 27

Ky statut përpilohet dhe firmoset nga Ortaku i Vetëm.

Ortaku i vetëm
(Frano Kulli)



AKT THEMELIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Enti privat :Shtypshkronja "Gjergj Fishta" Lezhë" (shpk) ,me pronar Z.Frano Kulli krijohet nga Ortaku i Vetëm dhe administratori i vetëm i saj në mbështetje të legjislacionit në fuqi,të ligjit Nr. 7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private,të nismës së lirë,të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit" dhe të ligjës nr. 7638,datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Objekti i veprimtarisë:

- Shtypshkrime të gazetave,revistave,librave e të tjera të këtij lloji që botohen brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë tij.
- Shtypshkrime të porositësve shtetrorë e privatë,nga të gjithë sektorët.
- Import-export të paisjeve e lëndëve të para që lidhen me aktivitetin e shtypshkronjës.
- Tregtim (import-export) të paisjeve elektronike,kompiuterike,paisje grafike të çfarëdo lloji si dhe artikuj shkollor.
- Tregtim i librit artistik e shkencor,kaseta e videokaseta.

Shoqëria drejtohet nga Ortaku i Vetëm dhe ka për detyrë:

- Të organizojë punën dhe të ndajë detyrat për çdo antar të shoqërisë.
 - Të derdhë detyrimet e buxhetit në kohë.
 - Të nxjerrë informatat e bilancit ekonomik e financiar dhe të informojë organet kompetente.
 - Të përfaqësojë shoqërinë e tij në gjykatë dhe në organet e tjera shtetrore.
 - Nxjerr para përgjegjësisë punonjësit që shkaktojnë dëme në kryerjen e detyrës për faj të tyre.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqindmijë) lekë
 - Administratori i vetëm i shoqërisë është i nënshkruari.
 - Qendra e veprimtarisë është në qytetin e Lezhës,lagja "Skënderbeg".
 - Jetëgjatësia e shoqërisë është në një afat mbi 12 vjet të njëpasnjëshëm.

Ortaku i vetëm
(Frano Kulli)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA Nr975 rep



"e lezhe me dt 24.5.1994 une s'presë „apa me detyre notere ne gjykatën e rrethit lezhe u paraqit para meje Z. Frano Kulli identitetin e te cilit e verifikova me leter njoftimin qe kishte me vete, i cili kerkoi prej meje verifikimin e nenskrimit te tij te mesiperm i cili rezultoi i njejete me ori gjinalin, i cili pohoi se akti i mesiperm eshte perpiluar konform vullnetit te tij te lire dhe e miratoj si me poshte vijon:

NOTERE

SHPRESA PAPA

